



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1998/11 prot.

Tiranë, më 18.03.2022

UDHËZIM

Nr. 2 Datë 18.03.2022

MBI RAPORTIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të gërmës "b" të nenit 23, pikës 2 dhe 3, të nenit 125, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (në vijim "LPP"), pikës 5, 6, dhe 8, të nenit 107 dhe nenit 115 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar (në vijim "VKM"),

UDHËZON:

1. Personi apo strukturat e ngarkuara nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi, duhet të ndjekin me përpikmëri ecurinë e zbatimit të kontratës, sipas planit të zbatimit të nënshkruar midis autoritetit/entit kontraktor dhe operatorit ekonomik, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës.
2. Personi apo strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës, i përcjellin personit përgjegjës për prokurimin, raportimet lidhur me ecurinë e zbatimit të kontratës, të cilat dërgohen prej këtij të fundit, pranë APP-së.
3. Në formularin e raportimit për zbatimin e kontratës janë parashikuar dy rastet e raportimit:
 - a) Raportim i ndërmjetëm, gjatë fazës së zbatimit të kontratës;
 - b) Raportim përmbledhës, në përfundim të zbatimit të kontratës.
4. Gjatë zbatimit të kontratës, personi ose strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës përgatisin një raport të ndërmjetëm sa herë evidentohen situata dhe problematika të ndryshme, që ndikojnë në zbatimin e kontratës sipas termave dhe kushteve të saj, apo sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në legjislacionin në fuqi.

Në raportin e ndërmjetëm përfshihen:

- a) informacioni mbi të dhënat e kontratës, të tilla si Nr. Prot., datë, datën e lidhjes së kontratës, datën e hyrjes në fuqi, kohëzgjatjen, vlerën, sigurimin e kontratës, nëse ka fond rezervë, nëse është kontratë në bazë të një marrëveshje kuadër, numrin e referencës së procedurës/lotit të përfunduar me nënshkrimin e kësaj kontrate, tipin e kontratës, kontraktori/ët, nënkontraktori, mbikëqyrësi dhe kolaudatori për kontratat e punëve;
 - b) situatat konkrete të evidentuara gjatë zbatimit, sipas rastit, të tilla si modifikimet e kontratës, ndërprerja, përfundimi apo shpallja e pavlefshme e kontratës, si dhe arsyet, rrethanat dhe argumentimi përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës;
 - c) problematika të tjera të evidentuara, gjatë zbatimit të kontratës, si dhe masat dhe veprimet e ndërmarra nga autoriteti/enti kontraktor në lidhje me problematikat e evidentuara.
6. Në përfundim të kontratës, personi ose strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës përgatisin raportin përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.

Në raportin përmbledhës përfshihet:

- a) informacioni mbi të dhënat e kontratës, sipas përcaktimeve të paragrafit të dytë të shkronjës "a", të pikës 5, të këtij udhëzimi;
- b) informacioni mbi të gjitha situatat apo problematikat e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti;
- c) informacioni nëse kontrata është zbatuar me korrektësi dhe cilësi;
- d) informacioni në lidhje me parashikimet e kontratës për kryerjen e pagesave dhe informacioni për likuidimin ose jo të kontratës.

Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së nga personi përgjegjës për prokurimin, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës.

7. Raportimi i ndërmjetëm dhe raportimi përmbledhës për zbatimin e kontratës, bëhet sipas formularit standard për raportimin e zbatimit të kontratës, pjesë e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

